

## **Enver Hoxha i gjykuar sipas titujve të librave të tij të konceptuar si testament epigramatik**

Saturday, 13 October 2007

Nga Kastriot Myftaraj - Enver Hoxha mund të vlerësohet epigramatikisht sipas titujve të librave të tij. Enver Hoxha e dinte mirë atë që kishte thënë Lenini për rëndësinë e sloganeve, parullave lakonike, prandaj dhe titujt e librave të tij Enver Hoxha i ka bërë që të shërbejnë në këtë mënyrë, pra si postulate të politikës së brendshme dhe të jashtme shqiptare, edhe pas vdekjes së tij. Në këtë testament epigramatik Enver Hoxha përcakton se cilët vende janë të rrezikshëm për Shqipërinë, cilët vende dhe popuj janë miq të shqiptarëve etj. Ajo që të bën përshtypje tek titujt e librave të Enver Hoxhës është se të vetmet vende, të cilët ai i përcakton si armiq që në titullin e librave të tij, paralajmëron për rrezikun që u vjen shqiptarëve prej tyre dhe për të cilët shpreh posaçërisht urrejtjen janë vendet anglosakse, SHBA dhe Britaninë e Madhe, gjë që nuk e bën për asnjë nga vendet e tjera për të cilat shkruan libra. Kështu, në vitin 1982 Enver Hoxha botoi librin e vet me kujtime dhe mendime për marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet anglo-sakse, «Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë» (Shtëpia botuese «8 nëntori», Tiranë 1982). Është interesante dhe sinjifikuese se Enver Hoxha, tashmë kishte botuar librin për marrëdhëniet shqiptaro-ruse (sovjetike), të cilit i kishte vënë titullin «Hrushovianët» (Shtëpia botuese «8 nëntori», Tiranë, 1980) dhe jo «Rreziku sovjetik (nënkupto: rus) për Shqipërinë». Duke e titulluar «Hrushovianët» librin e vet për marrëdhëniet shqiptaro-ruse (sovjetike), Enver Hoxha e vinte veten në pozitën e stalinianëve, pasi hrushovianë Hoxha quante antistalinianët që morën pushtetin në Kremlin pas vdekjes së Stalinit. Pra, për sa i përket Rusisë Enver Hoxha nuk shikon për shqiptarët ndonjë rrezik për të gjitha kohërat, si në rastin e vendeve anglo-sakse, por një rrezik që vjen nga disa persona që në atë kohë ishin në pushtet. Ajo që të bën përshtypje është se edhe librin e vet për marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, Enver Hoxha e titulloi «Titistët» (Shtëpia botuese «8 nëntori», Tiranë 1982) dhe jo p.sh. «Rreziku jugosllav për Shqipërinë», apo «Rreziku serbomadhi për Shqipërinë». Në mënyrë domethënëse Enver Hoxha shikonte si armiq të shqiptarëve në Beograd titoistët, pra atë lob të Jugosllavisë komuniste, që përbëhej kryesisht nga joserbë, me kroatin Tito në krye, dhe që ishin antistalinistë, si dhe të lidhur me Perëndimin, posaçërisht me SHBA. Ata që Enver Hoxha i quan titistë ishin ata që kufizuan peshën dhe influencën e Serbisë dhe serbëve në federatën komuniste jugosllave, dhe për këtë ndër të tjera u dhanë të drejta të mëdha shqiptarëve, posaçërisht në Kosovë. Shqiptarët e Jugosllavisë komuniste, posaçërisht ata të Kosovës, fituan të drejta të mëdha vetëm pasi titoistët arritën të dobësojnë fuqinë e lobit serb, duke larguar nga pushteti kreun e tij Rankoviqin. Rankoviqi që shihej si trashëgimtar i Titos, dukej se do ta afronte Jugosllavinë më tepër me Rusinë, në rast se do të vinte në pushtet pas vdekjes së Titos. Prandaj amerikanët e nxitën Titon në 1966, kur ai ishte 74 vjet dhe i ishin diagnostikuar sëmundje shqetësuese, që të merrte masa për të rregulluar çështjen e trashëgimisë së pushtetit, duke larguar Rankoviqin që amerikanët e gjenin të papërshtatshëm. Kur Enver Hoxha shprehej për rrezikun titoist për Shqipërinë, ai këtë e shikonte si pjesë të «Rrezikut anglo-amerikan për Shqipërinë» se titoistët ai i quante si agentë të SHBA. Enver Hoxha sigurisht që e dinte se në rast se në Beograd binin nga fuqia titoistët, atëherë në vakumin e krijuar do të ngriheshin serbët rankoviqistë, gjë që u duk në fund të viteve të tetëdhjeta kur titoistët u dobësuan shumë në Beograd dhe serbët rankoviqistë filluan fushtatën për të marrë federatën nën kontroll, duke e orientuar politikën e Beogradit kah armiqësia me SHBA dhe afrimi me Rusinë. Ngritja e Millosheviqit ishte revanshi i rankoviqizmit të larguar nga pushteti në vitin 1966. Enver Hoxha, duke u shprehur për rrezikun anglo-amerikan,

për Shqipërinë, si dhe për rrezikun titoist dhe hrushovian për të, vihej në fakt në të njëjtën linjë me serbët dhe u çonte atyre kumtin lakonik dhe të qartë sa s'bëhet se kishin të njëjtët armiq, Titon dhe SHBA dhe se me Rusinë nuk i ndante veçse hrushovizmi. Gjëja më interesante është se Enver Hoxha filloi t'i lëshonte këto epigramë politike dhe gjeopolitike në vitin 1980, pra në kohën që Shqipëria ishte prishur me Kinën dhe kishte mbetur plotësisht e izoluar, që Tito kishte vdekur (ai vdiq në 1980 kur tashmë pritej të vdiste). Enver Hoxha e dinte se me vdekjen e Titos do të tronditej rëndë federata jugosllave, për të cilën paralajmërohej se do të shpërbëhej jo shumë kohë pas vdekjes së Titos. E megjithatë Enver Hoxha përsëri e definon titoizmin si armik të shqiptarëve në dy anët e kufirit. Kjo nuk mund të merrej ndryshe veçse si shërbim dhe kumt miqësie i tij për serbët. Në librin «Titistët» Enver Hoxha paraqiti publikisht të ashtuquajturën tablo sinoptike për komplotin e Mehmet Shehut, të quajtur prej tij si poliagjent. Enver Hoxha e përcaktoi Mehmet Shehun se në vitin 1981, pas demonstratave shqiptare në Kosovë, Shehu, me urdhër të UDB dhe të CIA kishte dashur të vriste Enver Hoxhën për të destabilizuar Shqipërinë, në mënyrë që titoistët të shpëtonin nga problemi që u ishte hapur në Kosovë, duke e çuar atë në Republikën e Shqipërisë. Kështu, sipas Enver Hoxhës dilte se SHBA, pas vdekjes së Titos ishin duke ndihmuar serbët kundër shqiptarëve në Jugosllavi. Kjo sigurisht që nuk ishte e vërtetë. Ne, tashmë në retrospektivë, e kemi të qartë se, në 1981 CIA nuk kishte interes t'i çlironte serbët nga problemet që ata kishin në Kosovë me shqiptarët, se CIA pas vdekjes së Titos nuk ishte më e interesuar për ekzistencën e federatës komuniste jugosllave. SHBA e shihnin shpërbërjen e federatës jugosllave si një pikënisjen e shpërbërjes së bllokut komunist të dominuar nga Bashkimi Sovjetik dhe të vetë Bashkimit Sovjetik. Në 1981, kur ndodhën demonstratat në Kosovë, blloku komunist ishte duke u goditur seriozisht në dy pika, në Poloni, me lëvizjen «Solidarnost» dhe në Afganistan, me ndihmën që CIA u jepte mohaxhidinëve antisovjetikë. Demonstratat në Kosovë sigurisht që kanë qenë pjesë e kësaj strategjie. Pasi serbët i imponuan federatës jugosllave që të ushtrojë represion mbi shqiptarët e Kosovës në vitin 1981, këta të fundit dhe shqiptarët në Jugosllavi në përgjithësi, shpresonin vetëm tek SHBA për çlirimin e tyre, se dëgjonin që «Zëri i Amerikës» i bëri jehonë të madhe protestës së shqiptarëve të Kosovës, dhe pasqyroi represionin serb me tone fajësuese. Në këtë kohë, Enver Hoxha u bëri një shërbim të madh serbëve duke tentuar që të kultivojë mosbesimin ndaj SHBA të shqiptarëve të Kosovës dhe të atyre në ish-Jugosllavi në përgjithësi, duke thënë se CIA bashkëpunonte me UDB kundër shqiptarëve të Kosovës. Me këtë Enver Hoxha tentoi t'i armiqësonte shqiptarët e Kosovës me SHBA, gjë që parë në retrospektivë, del se ishte në interesin e madhe të Serbisë dhe të Rusisë. Në tablonë sinoptike të Enver Hoxhës, të botuar tek libri «Titistët» KGB ruse shkëlqen me mungesën e saj në intrigat e shërbimeve sekrete kundër shqiptarëve të Kosovës. Enver Hoxha thotë se Shehu ishte dhe agjent i KGB, por në rastin e veprimeve anti-Kosovë të vitit 1981, Hoxha thotë se Shehu zbatonte urdhrat vetëm të CIA dhe UDB. Për të shlyer disi përshtypjen e keqe, që u krijua nga «harresa» që po i bënte Hoxha Rusisë, ai në nëntor 1982 mbajti një fjalim ku u shpreh në terma të forta për rrezikun e një sulmi ushtarak rus në Ballkan, në drejtim të bregdetit adriatik dhe jonian, në rrugë tokësore nëpërmjet Jugosllavisë jugore (Kosovës) dhe më tutje Republikës së Shqipërisë, si dhe të flotës ruse nga deti, drejt Vlorës. Hoxha u mburr se çelësin e Otrantos e kanë shqiptarët dhe se flota sovjetike nuk do ta kalonte dot Otranton, se bregu shqiptar ishte i fortifikuar dhe i armatosur, ndërsa sa i përket sulmit nga toka ai u shpreh se në këtë rast ushtria ruse do të haste rezistencën e parë nga shqiptarët e Kosovës, që do ta dëmtonin aq shumë sa kur të arrinte ushtria ruse tek Alpet në kufirin shqiptar, do të ishte reduktuar si ushtarët gjermanë kur iknin nga Stalingradi. Enver Hoxha e dinte

mirë se në rast se flota ushtarake detare sovjetike do të kërkonte të merrte nën kontroll Otranton, ajo do të kishte punë me flotën amerikane dhe NATO-n, çka do të çonte në një luftë botërore atomike, prandaj Enver Hoxha mund të qe i qetë se kjo gjë nuk do të ndodhte, kështu që i lejonte vetes të mburrej kot. Tekefundit, ishin amerikanët që në 1961 i larguan rusët nga Vlora, se po të qe për Enver Hoxhën, rusët do të ishin në Vlorë edhe në 1982, e ndoshta edhe sot. Sipas proces-verbalit të bisedës midis Enver Hoxhës dhe Hrushovit që u bë në Moskë, në 12 nëntor 1960 (në kohën kur mbahej Mbledhja e Moskës e 81 partive komuniste), Enver Hoxha u kërkonte rusëve mos ta largonin ushtrinë e tyre nga Vlora. Tek volumi 19 i veprave të Enver Hoxhës paraqitet ky dialog midis këtij të fundit dhe Hrushovit: «N. S. HRUSHOVI: Në qoftë se doni mund ta heqim bazën. SHOKU ENVER HOXHA: Atëherë del e vërtetë ajo që kanë thënë Malinovski dhe Greçko. Mos doni të na kërcënoni? Po të dëgjojë populli sovjetik se ju kërkoni të hiqni bazën nga Vlora, kur ajo shërben për mbrojtjen e Shqipërisë dhe të vendeve të tjera socialiste të Evropës këtë nuk do t'ua falë». (cituar sipas: Enver Hoxha: Vepra, vol. 19, Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste, Tiranë 1975, f. 379) Pra, është e qartë si drita e diellit, sipas dokumenteve që ka botuar vetë Enver Hoxha, se Enver Hoxha nuk e ka dashur largimin e rusëve nga baza e Vlorës, prandaj është qesharake ajo që thotë ai në 1982 se ka çelësat e Otrantos dhe se nuk do t'ua japë ato rusëve pa luftë. Në fakt Hoxha i tha të gjitha këto gjëra në vitin 1982, për t'i shërbyer propagandës serbe që në atë kohë dhe më vonë, por edhe sot, i terrorizonte psikologjikisht shqiptarët e Kosovës që shpresonin tek amerikanët, me atë se tekefundit serbëve do t'u vinte në ndihmë ushtria ruse, që do t'i shfaroste krejt shqiptarët e Kosovës dhe të Jugosllavisë në përgjithësi, prandaj ata duhet të rrinin urtë dhe t'u nënshtroheshin serbëve, të cilët në atë kohë kishin nevojë për qetësi në Kosovë se donin të merrnin në dorë frenat e federatës. Enver Hoxha u shërbeu serbëve duke i terrorizuar shqiptarët e Kosovës me mundësinë e një sulmi rus në Kosovë, gjatë të cilit ai parashikoi se shqiptarët e Kosovës do të luftonin me rusët dhe se ushtria shqiptare ndërkohë do t'i priste rusët në kufi, ku do të arrinin vetëm mbeturinat e ushtrisë ruse, që do të shkatërrohej nga shqiptarët e Kosovës. Enver Hoxha sigurisht që është i vetëdijshëm se po thotë një gënjeshtër të madhe dhe këtë gjë e kuptonin dhe kalamajtë e rugës në Prishtinë dhe në Drenicë, se në rast se ushtria ruse mësynte nëpër Jugosllavi në vitet e tetëdhjeta dhe hynte në Kosovë, në kufirin shqiptar nuk do të arrin mbetjet e ushtrisë ruse, por mbetjet e popullsisë shqiptare të Kosovës. Sigurisht që edhe hyrja e ushtrisë ruse në ish-Jugosllavi në atë kohë do të shkaktonte një luftë botërore dhe rusët nuk do ta bënin kurrë një gjë të tillë, aq më tepër në ato rrethana kur kishin probleme të mëdha në Azinë qendrore me luftën në Afganistan. Librin e vet në dy volume për marrëdhëniet shqiptaro-kineze, Enver Hoxha e titulloi «Shënime për Kinën» (Shtëpia botuese «8 nëntori», Tiranë 1979, 1980). Pra, titulli është neutral, ndryshe nga ai për marrëdhëniet e Shqipërisë me SHBA dhe Britaninë e Madhe. Një tjetër gjë mjaft sinjifikuese është se Enver Hoxha librin e vet për marrëdhëniet shqiptaro-greke e titulloi «Dy popuj miq» (Shtëpia botuese «8 nëntori», Tiranë 1985). Këtë nder Enver Hoxha ia bëri vetëm Greqisë, me të cilën kishte filluar të afrohej shumë pas prishjes me Kinën. Enver Hoxha, jo rastësisht, vizitën e famshme në Dropull, në zonën e minoritetit grek, ku në Grapsh foli dhe greqisht dhe u shpreh për afrim të dy vendeve, e bëri në vitin 1978, në prag të shpalljes së prishjes me Kinën, ku ishin kinezët ata që e braktisën satelitin e tyre komunist europian dhe jo e kundërta. Veçimi i miqësisë me Greqinë në tabelën e epigrameve të Enver Hoxhës, ishte dhe një kumt afrimi që u bëhej rusëve dhe serbëve, se Greqia, edhe pse vend i lidhur me Perëndimin dhe anëtar i NATO, ishte një vend që kishte probleme të mëdha në marrëdhëniet me SHBA, për shkak të

konflikteve historike me Turqinë, për çështjen e Qipros etj. Për Enver Hoxhën, nuk ekzistonte «Rreziku grek për Shqipërinë». Në kohën që Enver Hoxha botoi librin «Dy popuj miq» tashmë prej tre vitesh shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë shqiptare, ishte një minoritar grek, Kiço Mustaqi. Deri në vitin 1971, kur Shqipëria lidhi marrëdhënie diplomatike me Greqinë, Enver Hoxha i ishte trembur një sulmi ushtarak grek, se grekët donin Shqipërinë e Jugut të quajtur prej tyre Vorio-Epir. Greqia vazhdimisht refuzonte të lidhte marrëdhënie diplomatike me Shqipërinë, me gjithë kërkesat e kësaj të fundit. Greqia është vendi i vetëm të cilit Shqipëria komuniste i është lutur më së shumti për të lidhur marrëdhënie diplomatike. Në fillim të viteve shtatëdhjetë, kur Kina po afrohej me SHBA, në Athinë u trembën se mos Enver Hoxha, i mbetur vetëm, dhe duke iu trembur sulmit grek, ndiqte shembullin e Titos dhe afrohej me SHBA. Hapja e Shqipërisë kah Perëndimi nuk u vinte për mbarë as grekëve as miqve të tyre të gjithkohshëm serbëve, se nga kjo gjë do të humbnin dhe grekët dhe serbët. Prandaj Greqia shpejtoi të lehtësonte presionin mbi Shqipërinë, duke pranuar të lidhte marrëdhënie diplomatike dhe duke ulur shumë praninë ushtarake në kufirin me Shqipërinë. Enver Hoxha përfitoi nga kjo gjë për të filluar spastrimet në ushtri, në funksion të dizenjimit të klanit që do të trashëgonte pushtetin pas vdekjes së tij. Nuk është gjë e rastit që pjesa më e madhe e gjeneralëve që u spastruan në 1974 ishin ata që kishin mbajtur peshën kryesore në luftimet shqiptaro-greke të vitit 1949, por dhe në vitet e mëparshme dhe të mëvonshme, duke filluar që nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm në 1974, Petrit Dume etj. Enver Hoxha mund ta spastronte ushrinë vetëm duke pasur garanci nga Athina, së cilës i konvenonte kjo gjë. Në përfundim të procesit të spastrimit të ushtrisë, në 1982, Enver Hoxha pasi kishte pushkatuar shefin e shtabit të përgjithshëm që kishte luftuar kundër grekëve, ia dorëzoi çelësat e ushtrisë një greku, duke bërë shef të Shtabit të Përgjithshëm, Kiço Mustaqin, të cilin Ramiz Alia në 1990 e bëri dhe ministër të mbrojtjes. Me ardhjen e Mustaqit ushtria shqiptare u spastrua dhe nga oficerët me origjinë kosovare, deri dhe nga ata që kishin gruan me origjinë kosovare. Afrimi i Enver Hoxhës me Greqinë ishte vetëm uvertura e atij procesi që trashëgimtari i tij Ramiz Alia do ta çonte në kulm në kohën e ndryshimeve politike në Shqipëri, duke ua dorëzuar ekskluzivisht ortodoksëve çelësat e partisë në pushtet që po reformohej, çka ishte interesi i Greqisë, që ndiqte parimin se çdo ortodoks në Shqipëri është grek. Derisa Enver Hoxha shkroi një libër me një titull kaq dashamir për Greqinë, ai nuk e bëri këtë gjë për një tjetër vend fqinj si Italinë. Italia vërtet kishte qenë vendi që pushtoi Shqipërinë në luftën e fundit botërore, por edhe Greqia e kishte pushtuar Shqipërinë, madje ndryshe nga italianët grekët bënë masakra shumë të mëdha. Në një tjetër titull libri Enver Hoxha shprehet në sens antiperëndimor. Ky është libri «Eurokomunizmi është antikomunizëm» (Shtëpia botuese «8 nëntori», Tiranë 1980) Në fjalorin politik ndërkombëtar ekzistonin terma si sllavo-komunizëm, eurokomunizëm, komunizëm aziatik etj. Enver Hoxha prej tyre zgjodhi vetëm «eurokomunizmin» për ta vënë në shënjestër dhe denigruar në një titull libri se eurokomunizmin Hoxha e quan si proamerikan, pro-NATO, antistalinist. Enver Hoxha nuk bëri një libër me titull «Sllavo-komunizmi» është antikomunizëm. Titulli i librit «Kur lindi Partia» (Shtëpia botuese «8 nëntori», Tiranë 1988) ka një konotacion seksualo-gjinekologjik. Nuk thuhet «Kur u krijua partia» por «Kur lindi Partia». Lindja nënkupton incintim dhe incintimi iu bë nga Moska, nëpërmjet të dërguarve serbë të Kominternit. Duke konsideruar atë këngën e komunistëve shqiptarë të kohës «Bijtë e Stalinit jemi ne!» mund të thuhet se Shqipëria u përdhunua nga Stalini dhe Kominterni dhe nga kjo lindi partia dhe këta bij të Stalinit. Partia që lindi në 1941 në Tiranë u regjistrua në «regjistrin e gjendjes civile» të Kominternit në Moskë, gjë që thuhet në libër dhe në historinë e partisë, se akti i parë që bëri partia e porsakrijuar

ishite kërkesa për njohje dhe anëtarësim në zyrat e Kominternit në Moskë. Si pasojë edhe sot PS, trashëgimtarja ligjore e partisë të lindur në 1941, nuk figuron e regjistruar rregullisht në Shqipëri, se kur PPSH nuk ishte e regjistruar edhe sipas ligjeve shqiptare të kohës së komunizmit, kur në 1991 ndryshoi emrin në PS. Dhe PS u regjistrua si parti e re në mënyrë të kundraligjshme në 1991, se ligji kërkonte një tjetër procedurë për regjistrimin e një partie të re. Kështu e majta e sotme vuan ende lindjen e vitit 1941. Libri tjetër me kujtime për kohën kur po ndërtohej regjimi komunist, «Kur hidheshin themelet e Shqipërisë së re» (Shtëpia botuese «8 nëntori», Tiranë 1984), është i vetmi i cili që nga titulli tregon se qëllimi i kryesor i luftës së komunistëve ishte pushteti. Në libër me Shqipëri të re quhej Shqipëria komuniste dhe me themelet e saj themelet e pushtetit komunist. Libri, në mënyrë domethënëse e çon këtë periudhë të «hedhjes së themeleve», nga Konferenca e Pezës në shtator 1942 dhe deri në vitin 1946 kur u krijua republika popullore-eufemizëm i kopjuar nga Moska për regjimin komunist sipas formulës leniniste «demokraci popullore», duke treguar kështu se lufta antifashiste ishte bërë në funksion të pushtetit. Një ironi e madhe me librat e Enver Hoxhës do të ishte sikur në librin e tij me kujtime «Vite të Rinisë» (Shtëpia botuese «8 nëntori», Tiranë 1988), të zbatohet teoria që ai përdor për rininë e Mehmet Shehut. Në këtë libër Hoxha flet me shumë simpati për drejtorët francezë të Liceut të Korçës, ku ai ka studiuar. Ndërsa drejtorin e shkollës teknike amerikane, Harry Fultz, e quan një njeri të spiunazhit amerikan (që para Luftës së Dytë Botërore as që ekzistonte), që kishte ardhur në Shqipëri për të rekrutuar dhe përgatitur agjentë, posaçërisht ndërmjet nxënësve të shkollës që drejtonte. Mehmet Shehun, Mustafa Gjinishin etj., Enver Hoxha i quan agjentë të Fultz, të cilin e quan shef të spiunazhit amerikan në Shqipëri. Pse për francezët homologë të Fultz, Hoxha nuk ka këtë pikëpamje, kur edhe Franca kishte një spiunazh shumë të vjetër dhe me përvojë? Atëherë Franca ishte aleate e ngushtë e Jugosllavisë monarkiste të dominuar nga serbët, dhe Beogradi kishte interesa të mëdha në Shqipëri, kështu që spiunazhi jugosllav me siguri që do t'i kërkonte atij francez ta asistonte në Shqipëri. Dhe liceu francez në Shqipëri mund të bëhej për jugosllavët një vend i mirë për rekrutim agjentësh me anë të drejtorëve dhe mësuesve francezë. Kështu, po të përdorim teorinë e Hoxhës për Shehun, atëherë del që Hoxha është rekrutuar nga shërbimi sekret francez për llogari të atij serb, që në ato «Vite të Rinisë» kur ishte në Liceun e Korçës.

Gazeta Sot